



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 dhe nenit 3.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 21.12.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.FEHMI REXHEPI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Lipjan, nga subjekti politik “Partia e Ashkalinjëve për Integrim - PAI” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Lulzim Qerimi**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t’i komunikohet **z.Fehmi Rexhepit**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 20.12.2017, nr.2653/2017, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Lulzim Qerimi, pas dorëheqjes së tij të përvokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të propozimit për emërim si nënkryetar për Komunitetin.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirënditur, i cili është z.Fehmi Rexhepi, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 21.12.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka